



25 JANAR 2015

ECMI KOSOVA FTON PËR ARSYE DHE VEPRIM PAS PROTESTAVE NË PRISHTINË

Më 24 janar, përafërsisht 10,000¹ protestues morrën pjesë në një nga protestat më të mëdha të organizuara në Prishtinë kohëve të fundit, duke kërkuar që kryeministri Isa Mustafa të shkarkojë ministrin Aleksandar Jablanović për shkak të deklaratave të tij kontraverse, si dhe që Qeveria e Kosovës të marrë përsipër pronësinë mbi Trepçën, një kompleks të madh të minierave që është ekonomikisht i rëndësishëm për Kosovën. Protesta ishte thirrur dhe organizuar nga ana e Vetëvendosjes dhe OJQ-së “Thirrjet e Nënave”. Protestës iu bashkuan edhe partitë opozitare AAK dhe “Nisma për Kosovën” dhe liderët e tyre Ramush Haradinaj dhe Fatmir Limaj morrën pjesë në protestë. Albin Kurti, lideri i Vetëvendosjes dhe përfaqësuesit e OJQ-së “Thirrjet e Nënave”, i dhanë qeverisë ultimatum që të permbushë kërkesat e protestuesve deri më 26 janar. Nëse qeveria nuk i përmbush kërkesat e tyre, Vetëvendosje dhe “Thirrjet e Nënave” do të protestojnë sërish të martën, më 27 janar.

Edhe pse në përgjithësi protesta nuk ishte e dhunshme, në fund të saj ajo eskaloi në një episod të dhunës kur protestuesit filluan të hedhin gurë në drejtim të ndërtesës së qeverisë duke i thyer disa xhama në proces e sipër, ndërsa protestues tjerë thyen karriget dhe xhamat e disa bizneseve në afërsi të ndërtesës së qeverisë. Policia e Kosovës njoftoi opinionin se 22 protestues ishin arrestuar, ndërsa 19 pjesëtarë të policisë ishin lënduar gjatë protestave. Gazetarë serb të televizionit publik të Kosovës RTK2 u ngacmuan nga një turmë e protestuesve kur këta të fundit i dëgjuan duke raportuar në gjuhën serbe.² Nuk pati raporte për ndonjë incident tjetër të ngjajshëm në Kosovë, duke përfshirë në vendbanimet me shumicë serbe. ECMI Kosova i bën thirrje të gjitha palëve që të mbajnë qetësinë e tyre, dhe i bashkohet Presidentes së Kosovës, z. Atifete Jahjaga, duke përsëritur që e drejta për të protestuar në mënyrë jo të dhunshme është e pacënueshme.

Përfundimi i dhunshëm i protestës, tonet dhe atmosfera nacionaliste (flamuri shqiptar ishte i pranishëm gjithandej, ndërsa flamuri i Kosovës si për mrekulli nuk shihej askund, përderisa protestuesit për cak kishin gjithë Listën serbe), dhe incidenti me gazetarët që flisnin serbisht tregojnë për një rritje të përshkallëzuar të konfrontimeve etnike që kur Lista serbe u bë pjesë e

¹ Policia njoftoi për 10,000 protestues, ndërsa organizatorët njoftuan për 25,000 protestues.

² <http://www.gazetaexpress.com/lajme/momenti-kur-gazetarët-e-rtk2-u-sulmuan-nga-protestuesit-video-75778/>

PRESS RELEASE

Qeverisë së Kosovës. Siç e ka cekur edhe më herët ECMI Kosova në raportet e saj të fundit, fakti që ministrat e Listës serbe publikisht injorojnë apo refuzojnë të njohin Republikën e Kosovës dhe mbajnë lidhje të afërta me Qeverinë e Serbisë e ka vënë qeverinë e re në një rrëmujë të plotë.³

Ne i bëjmë thirrje të gjitha palëve të përfshira që të mos lejojnë që këto çështje të eskalojnë në dhunë të mundshme ndër-etnike, që do të dëmtonte jo vetëm marrëdhëniet ndër-etnike në Kosovë, por do të kthente prapa edhe përpjekjet e Kosovë për integrim të brendshëm po edhe evropian. Prandaj, i bëjmë thirrje Qeverisë së Kosovës që përgjatë vijave të raportit tonë të fundit për politika⁴, të krijojë një ambient pune në kuadër të Qeverisë së Kosovës në bazë të një marrëveshjeje themelore me Listën serbe që do të përcaktojë qartë dallimin në komunikimin nga ana e politikanëve në kapacitetin e tyre të zyrtarëve qeveritarë dhe në atë të axhendave afatgjate të partive politike të së cilave ju përkasin. Një marrëveshje e tillë do të zbuste rritjen e konfrontimeve ndër-etnike të cilat, siç qartazi tregojnë protestat e së shtunës, mund të dërgojnë në situata dhe incidente që janë të paparashikueshme dhe të vështira për t'u përmbajtur në një kohë kritike për përpjekjet e Kosovës për stabilizim të brendshëm dhe integrim në Bashkimin Evropian.

Për më shumë informata, ju lutem kontaktoni

ECMI Kosovo:

Tel: + 381 (0) 38 224 473

Email: info@ecmikosovo.org

Web: www.ecmikosovo.org

³ <http://www.ecmikosovo.org/?p=5989> and <http://www.ecmikosovo.org/?p=5992>

⁴ <http://www.ecmikosovo.org/?p=6044>